

LIGJ
Nr.7605, datë 15.9.1992

PËR NËNDARJET NË BASHKI E KOMUNA DHE ORGANIZIMIN E
FUNKSIONIMIN E BASHKISË SË TIRANËS

(Ndryshuar me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000)

(i përditësuar)

Në zbatim të neneve 5 e 6 të ligjit nr.7570, datë 3.6.1992 "Për disa shtesa në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. PËR NËNDARJET NË BASHKI

Neni 1

Në bashkitë e qyteteve me popullsi mbi 40 mijë banorë krijohen lagje administrative. Lagja, si rregull, duhet të ketë jo më pak se 20 mijë banorë.
Numri i lagjeve caktohet nga Këshilli i Ministrave.
Kufijtë midis lagjeve vendosen nga këshilli i bashkisë.

Neni 2

Në lagje funksionon aparati administrativ. Struktura dhe numri i punonjësve të aparatit të lagjes caktohet nga këshilli i bashkisë, kurse emërimi, shkarkimet e pagat e personelit të tij vendosen nga kryetari i bashkisë.

Punonjësit e administratës së lagjes varen drejtëpërdrejt nga seksionet ose zyrat e aparatit të bashkisë dhe përgjigjen para tyre për plotësimin e detyrave të ngarkuara.

Neni 3

Për drejtimin e punës së aparatit të lagjes, kryetari i bashkisë emëron një administrator të lagjes.

Administratori i lagjes kryen detyrat që caktohen nga këshilli i bashkisë. Ai kryen këto detyra kryesore:

1. Organizon, drejton e kontrollon punën e personelit të lagjes në përputhje me detyrat e dhëna nga bashkia.

2. Merr masa për zbatimin e ligjeve dhe të akteve të organeve të bashkisë nga personat juridikë e fizikë, shtetërorë a privatë, si dhe nga shtetasit.

3. Ngre probleme e bën kërkesa në organet e bashkisë dhe në aparatin e saj për plotësimin e nevojave të banorëve të lagjes.

4. Përgjigjet para kryetarit të bashkisë dhe zëvendësave të tij për plotësimin e detyrave nga personeli i administratës së lagjes.

II. PËR NËNDARJET NË KOMUNA

Neni 4

Në komuna krijohen nëndarje administrativo-tokësore mbi bazë fshati.

Neni 5

Krijimi i fshatrave të reja ose bashkimi i tyre bëhet nga këshilli i rrethit, duke organizuar paraprakisht referendum.

Neni 6

Fshati drejtohet nga kryeplaku (kryetari) që caktohet nga pleqësia (përfaqësia) e fshatit, që është organ këshillimor i tij.

Anëtarët e pleqësisë (përfaqësisë) caktohen nga secila lagje ose fshati në mbledhje të hapët, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e atyre që kanë të drejtë vote.

Kryeplaku (kryetari) e pleqësia (përfaqësia) caktohen për një periudhë 2 vjeçare.

Numri i anëtarëve të pleqësisë (përfaqësisë) caktohen nga këshilli i komunës mbi bazën e numrit të lagjeve dhe të banorëve të fshatit.

Vendimet e organeve të komunës janë të detyrueshme për kryeplakun (kryetarin).

Caktimi dhe veprimtaria e kryeplakut (kryetarit) dhe i pleqësisë (përfaqësisë) mbikqyret nga organet e pushtetit të komunës.

Neni 7

Kryeplaku (kryetari) i fshatit nuk është funksionar.

Kriteret për shpërblimin e tij për punën që kryen caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

Kryeplaku (kryetari) i fshatit kryen detyra që përcaktohen në rregulloren e këshillit të komunës në përputhje me kushtet specifike të vetë komunës e të fshatit përkatës.

Ai merr pjesë në mbledhjen e këshillit të komunës pa të drejtë vote.

Në mënyrë të veçantë kryen këto detyra:

1. Kujdeset për ruajtjen e rendit publik në fshat në bashkëpunim me policinë.
2. Merr masa për plotësimin e nevojave me karakter social e komunal të fshatit, siç janë ato të shërbimit të varrezave, të mirëmbajtjes së mjediseve kulturore e sportive, rrugëve, të ujësjellësve, të linjave telefonike, elektrike etj., në përputhje me fondet e akorduara në buxhet, nga investitorë të ndryshëm ose edhe me kontributin e vetë banorëve.
3. Cakton mënyrën e shfrytëzimit të burimeve me ujë të pijshëm, mënyrën dhe radhën e përdorimit të ujërave për ujitje, si dhe dhe rregullat për shfrytëzimin e kullotave e të pyjeve që janë prona fshati ose në përdorim të tij.
4. Shqyrton kërkesat e ankesat e banorëve të fshatit dhe bën përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.
5. Merr masa për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit në fshat.
6. Kontrollon zbatimin e disiplinës nga punonjësit e komunës që punojnë në fshat dhe informon për punën e tyre kryetarin e komunës.
7. Parashtron në organet e pushtetit të komunës ose në organet më të larta probleme me interes për banorët e fshatit dhe u jep përgjigje këtyre të fundit për zgjidhjet e tyre.

ai. 8. U lëshon vërtetime banorëve të fshatit për fakte e të dhëna të njohura mirë nga vetë

III. PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIT E BASHKISË SË TIRANËS
(*Shfuqizuar me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000*)

Neni 9
(*Shfuqizuar me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000*)

Neni 10
(*Shfuqizuar me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000*)

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.305. datë 21.9.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha.**